



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:236887

Datë: 08.10.2024

Numri i dokumentit: 06267466

C.nr.6277/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Rr. Z., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura “K. & A.”, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontestit kompensim i ushqimit (shujtave), jashtë seancës, me datë 08.10.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M
(PA SHQYRTIM)

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Rr. Z. dhe DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë, që paditësit Rr. Z., në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për periudhën kohore prej 01.01.2020 deri në 18.11.2022, gjithsej për 653 ditë pune, t’ia paguaj shumën prej 1,306.00€, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë (03.11.2023) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e pasojave ligjore - përmbarimit të dhunshëm.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit përtej shumave të gjykuara si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi në emër të kompensimit për ushqim për periudhën nga data 18.04.2017 deri më 31.12.2019, për gjithsej 610 ditë pune në shumën prej 1,220.00€, si e pabazuar.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguaj shumën prej 124.00€, në afat prej 7 ditësh nga marrjes së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate, me datë 03.11.2023, ka parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensim për ushqim. Në padi ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura, në SH.M.L “Xhevdet Doda” në Prishtinë si mësimdhënës. Tutje ka theksuar se paditësit nuk i është bërë kompensimi për ushqim ditor në vlerë prej 2€ dhe atë nga data 18.04.2017 deri në 18.11.2022 apo 1263 ditë në shumën prej 2,526.00€, me kamatë ligjore 8% nga dita e parashtrimit të padisë e deri në

pagesën definitive. Po ashtu ka theksuar se bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit, paditësit i takon e drejta për kompensim për ushqim gjatë punës në bazë të nenit 35 par. 7 të kësaj kontrate të nënshkruar mes Ministrisë së Arsimit dhe SBASHK-ut, duke kërkuar nga gjykata që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, për arsye se një kompensim i tillë nuk është paraparë as me Ligjin e Punës nr.03/L-212. Po ashtu ka shtuar se, në rastin konkret ekziston parashkrimi i kërkesës pasi që konform dispozitave të Ligji të Punës dhe Ligjit të marrëdhënieve të detyrimeve. Tutje ka theksuar se e paditura gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë në skemën e saj buxhetore, linje të veçantë buxhetore për këto lloje të kompensimeve. Prandaj, ka kërkuar nga gjykata pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Pasi që Gjkata bëri vlerësimin e provave të bashkangjitura padisë, si dhe pas pranimit të përgjigjes në padi, mbështetur në nenin 8 dhe 398 të LPK-së, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, por se e paditura ka ngritur çështje që kanë të bëjnë me pamundësinë e përmbushjes së detyrimit. Në këtë rast kontestues është vlerësuar se nuk ka pengesa në kuptim të dhënies së vendimit meritot jashtë seance.

Nga provat e bashkangjitura padisë gjykata gjeti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, sipas kontratës me nr.prot.49/13 të datës 02.09.2013.

Gjkata përmes vërtetimeve të datës 26.11.2020 dhe 18.10.2023 mbi përvojën e punës dhe ditët e prezencës në punë gjeti se paditësi, nga data 01.01.2020 deri në 18.11.2022, ka gjithsej 653 ditë prezent në punë.

Nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditësi nuk ka pranuar kompensimin në emër të ushqimit për ditët e kaluara në punë, në kohën sa ka qenë në fuqi KKAK. Nga vërtetimi i gjendjes faktike, vërehet se paditësi ka 653 ditë prezent në punë, prandaj gjykata ditët e kaluara në punë të paditësit i ka shumëzuar 2€, rrjedhimisht duke u njohur shumë në si në pikën I dispozitiv të këtij aktgjykimi. Këtë lloj kompensimi gjykata i'a njohu paditësit në harmoni me nenin 35 par.7, të KKAK-së: "Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqime gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2(dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore".

Gjkata duke ju referuar Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës dispozitat e së cilës aplikohen në tërë Republikën e Kosovës, ku

në nenin 35 është paraparë e drejta punëtoreve të arsimit në kompensimin e ushqimit, gjeti se e njëjta është e aplikueshme nga hyrja në fuqi me datë 18.04.2017. Pas skadimit të kësaj kontrate, është nxjerrë kontrata e re, e cila i'u garanton punonjësve të arsimit këto të drejta.

Nga të lartcekurat gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit jashtë seance, në kuptim të nenit 398 i LPK-së, sipas të cilit “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Duke qenë se ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për kompensim të ushqimit (shujtave), i njëjtit është legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditësi e ka rolin e kreditorit kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shumat si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadisë së paditësit në emër të ushqimit (shujtave) për periudhën nga data 18.04.2017 deri më 31.12.2019, gjithsej për 610 ditë pune në shumën prej 1,220.00€, gjykata ka gjetur se për këtë periudhë paditësi e ka humbur të drejtën për realizimin e kompensimit për ushqim gjatë punës për faktin se i njëjti padinë në gjykatë e ka paraqitur në datën 03.11.2023, rrjedhimisht ka kaluar afati 3 vjeçar, kjo bazuar në dispozitën e nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, (e cila dispozitë ka karakterin prekluziv) ku lidhur me kërkesat në para nga marrëdhënia e punës është paraparë afati i parashkrimit ashtu që është përcaktuar se: “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.”, andaj gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa kundërshtimeve tjera të paditurës me përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, sepse e paditura nuk e konteston bazën e kërkesës, e as lartësinë e kërkesës së paditësit, me anë të përgjigjes në padi. Ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës, se për këtë objekt të kërkesë e paditura nuk ka planifikuar buxhet dhe nuk kanë vijë buxhetore për ta realizuar këtë kompensim, nuk është rrethanë e natyrës juridike që ndikon për të marr vendim ndryshe në këtë rast. Prandaj gjykata erdhi në përfundim se faktet në këtë rast, nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor dhe se pala e paditur është obliguar ta përmbush obligimin ndaj paditësit.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit,

përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, e do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë datë 03.11.2023.

Gjykata vendosi si në dispozitivin e III të këtij aktgjykimi, ashtu që e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 124.00€, në kuptim të nenit 452 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumë prej 104.00€ - sipas tarifës së OAK dhe taksa gjyqësore në shumë prej 20.00€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.6277/2023, më 08.10.2024

Gjyqtari
Përparim Zeka

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.